

## Nordrhein-Westfalen zgjat Urdhëresën për Mbrojtjen nga Koronavirusi: Lejohen më shumë spektatorë në evenimente sportive

Sinjale të qarta për sportet amatore dhe për sportet e kohës së lirë në Nordrhein-Westfalen / Landet bien dakord në lidhje me rregullat për spektatorët tek evenimentet sportive të skuadrave

Qeveria e Landit ju komunikon:

Kabineti i Landit ka vendosur të martën më datë 15 Shtator 2020 të zgjasë urdhëresat për mbrojtjen nga koronavirusi deri në 30 Shtator 2020 (duke e përfshirë këtë datë). Ndryshimet janë kryesisht në sektorin e sporteve: këtu lejohen më shumë spektatorë dhe spektatore për të gjitha kategoritë në mjediset sportive. Për më tepër Landet kanë rënë dakord për një procedurë të përbashkët në lidhje me spektatorët tek evenimentet sportive kombëtare të skuadrave dhe si rrjedhim edhe tek ndeshjet e Bundesligës, duke patur parasysh sfidat e veçanta të ndjeshjeve të skuadrave dhe interesimin përkatës të fansave.

Përgjatë një periudhë provë fillestare e cila do të zgjasë 6 javë, do të jetë e mundur të zhvillohen përsëri evenimente sportive kombëtare skuadrash me spektatorë e spektatore ,me kusht që të zbatohen rregullat strikte për higjienën dhe mbrojtjen nga infeksioni.

Kryeministri Laschet: „ Ne kemi premtuar një vendim të qartë në lidhje me kushtet thelbësore për mijëra klubet e sporteve në Nordrhein-Westfalen. Evenimentet sportive marrin jetë prej mbështetjes së fansave, prej atmosferës me publikun - kjo vlen si për lojërat e Bundesligës, ashtu dhe për sportet amatore dhe të kohës së lirë. Prandaj kemi shkëmbyer informacione me sektorin e sporteve amatore dhe kemi kërkuar një zgjidhje të shpejtë dhe të njëtrajtshme për evenimentet sportive kombëtare në rrethin federal.

Sot ne po i implementojmë të dyja këto tek ligji i aplikueshëm, duke krijuar si rrjedhim një pjesë të mëtejshme të një normaliteti të përgjegjshëm. Nëpërmjet planeve të sigurta të mbrojtjes nga infeksioni dhe kufizimeve në lidhje me kapacitetin, klubet mund t'i mbushin më në fund përsëri me jetë mjediset e tyre sportive. Vazhdon të vlejë fakti që kanë prioritet planet për higjienën, masat mbrojtëse dhe një sjellje e kujdesshme. “

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann: „Sektori i sporteve është gjendur në një testim të vështirë në muajt e fundit. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se sektori i sporteve gjallërohet prej spektatorëve dhe atmosferës në stadiume. Kjo gjë i ka munguar dhimbshëm shumë njerëzve. Është gjithashtu e qartë se mbrojtja nga infeksioni dhe si rrjedhim mbrojtja e shëndetit duhet të jenë prioritet kryesor. Prandaj po i afrohem me kujdes riautorizimit të një numri të limituar të spektatorëve. Por vetëm nëse është marrë parasysh situata rajonale e infeksionit dhe janë siguruar masat për mbrojtjen nga infeksioni dhe për higjienën. Kjo do të jetë sigurisht një sfidë e re për të gjithë personat e përfshirë. Në tërësi, i kemi kapërcyer me sukses të gjitha sfidat deri tani. Dhe jam i sigurt se mund ta kalojmë me sukses dhe këtë rast, nëse çdo spektator do

të ndjekë kërkesat e veçanta në vendndodhje në një mënyrë të disiplinuar dhe të përgjegjshme.“

### **Rregulla të reja për evenimentet sportive**

Duke filluar nga data 16 shtator, do të lejohen sërish të marrin pjesë në evente sportive ose në konkurse më shumë se 300 spektatorë, me kushtin e paraqitjes së një plani higjienë dhe mbrojtje nga infeksioni . Nëse ka më shumë se 1000 spektatorë, duhet të zbatohet rregulli i një limiti të sipërm i një të tretës së kapacitetit të mjediseve sportive, pra njësoj si për eventet e tjera. Rregullorja e numrit të pjesëmarrësve në sportet pa kontakt fizik është zgjeruar gjithashtu në favor të sporteve me sasi të jashtëzakonshme pjesëmarrësish, në mënyrë që të gjithë lojtarët dhe lojtaret të cilët nevojiten për sportin përkatës të mund të marrin pjesë në lojë - edhe nëse kalohet numri i 30 lojtarëve. Qeveria e Landit po implementon si rrjedhim atë çfarë është vendosur javën e kaluar në një samit të përbashkët me përfaqësuesit dhe përfaqësueset e klubeve dhe shoqatave të sporteve. Rregullore të veçanta vlejnë për eventet sportive kombëtare të skuadrave si pjesë e një periudhe prove.

### **Marrëveshja e Landeve për eventet sportive kombëtare të skuadrave**

Landet kanë rënë sot dakord për pikat e mëposhtme kyçe për pranimin e spektatorëve dhe spektatoreve tek ndeshjet e Bundesligës dhe tek konkurset kombëtare të sporteve të skuadrës:

- Përgjatë një periudhë prove 6 javore, duhen testuar planet e higjienës të cilat shërbejnë si bazë për pranimin e spektatorëve në evente sportive kombëtare.
- Është marrë parasysh situata aktuale e pandemisë. Për shembull nuk do të lejohen spektatorë në evente nëse incidenca 7 ditore për 100.000 pjesëmarrës tek vendndodhja e eventit është 35 ose më e madhe se 35 dhe nëse incidenca e infeksionit nuk mund të kufizohet dukshëm.
- Kërkesa e distancës prej 1.5 metrash duhet të plotësohet duke reduktuar kapacitetin maksimal të audiencës, duke ekuilibruar rrjedhën e vizitorëve tek hyrja dhe tek dalja dhe duke ndaluar shërbimin dhe konsumin e alkolit.
- Është e detyruar mbajtja e maskës e cila mbulon hundën dhe gojën, deri sa të qëndroni në këmbë ose të rrini ulur. Duhet të mundësohet ajrosje e mjaftueshme e ambientit ku do të zhvillohet eventi.
- Numri i lejuar i spektatorëve përcaktohet individualisht për secilën vendndodhje eventi. Kapaciteti maksimal i lejuar gjatë veprimtarisë provë 6 javore është 20 përqind e stadiumit ose sallës përkatëse për më shumë se 1000 spektatorë.

Ndryshimet në të gjitha urdhëresat e Landit të Nordrhein-Westfalen hyjnë në fuqi që nga e mërkura më datë 16 Shtator 2020.

Urdhëresat përkatëse do të publikohen gjatë ditës tek [www.land.nrw](http://www.land.nrw).

***Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet, në adresën e internetit të qeverisë së Landit [www.land.nrw](http://www.land.nrw)***

**[Informacion i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave në rrjetet sociale](#)**